

Thirrje për aplikime: Edicioni i katërt i çmimit “Liljana Isakaj” - Për LiderShip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural dhe Shoqata e Zhvillimit të Bujqësisë të Rretheve Malore - ADAD Malore, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural hapin thirrjen për edicionin e katërt të çmimit **“Liljana Isakaj”- Për LiderShip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale**. Ky çmim promovohet çdo vit më 15 tetor me rastin e ditës ndërkombëtare të grave në zonat rurale. Në këtë datë, organizohet eventi i përvitshëm “Pro Grave Rurale”, me synimin për të nxitur solidaritetet mbarëshoqëror për fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave në zonat rurale.



Prezantimi i çmimit “Liljana Isakaj”- Për LiderShip në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale

Ky çmim përfaqëson një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së pasur të Liljana Isakaj, e cila ia kushtoi jetën zhvillimit rural dhe fuqizimit ekonomik të grave rurale. Si epitome e grave rurale, Liljana hapi rrugën për progres, liderShip dhe ndryshim pozitiv në komunitetet rurale. Liljana Isakaj punoi për shumë vite si koordinatore pranë organizatës ADAD Malore. ADAD është një organizatë me profil të konsoliduar dhe me përvojë mbi 25 vjeçare në punën me prodhuesit e vegjël dhe bashkëpunimin bujqësor në rajonet malore si Dibra, Korça, Kukësi, Malësia e Madhe, Shkodra etj.

Liljana ka qenë në krye të shumë nismave e projekteve që kanë mbështetur prodhuesit e vegjël, veçanërisht ata në zonat malore të angazhuar në prodhimin, përpunimin, promovimin dhe diversifikimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Puna dhe përkushtimi i Liljanës në ndihmë të grave rurale e kanë bërë të jetë epitoma e gruas rurale. Historia e Liljanës frymëzon dhe nxit për veprim të gjithë aktorët e angazhuar në fuqizimin e grave dhe vajzave dhe përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale.

Çmimi “Liljana Isakaj” vlerëson individë që kanë kryer përpjekje për të përmirësuar jetën e grave të angazhuara në bujqësi dhe zhvillimin rural. Kjo nismë synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare, duke vlerësuar udhëheqësit/liderët në zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe të krijojë një rrjet të personave që sjellin ndryshimin dhe më tej përforcojnë përpjekjet e tyre në nivel lokal dhe kombëtar. Të nominuarit/at për këtë çmim duhet të kenë dhënë kontribut në fuqizimin e grave të angazhuara në sektorin bujqësor dhe rural dhe përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale.

Kush mund të aplikojë?

Janë të ftuara të gjitha organizatat e sektorit civil, institucionet publike si në nivel kombëtar dhe lokal, bizneset apo subjekte të ndryshme, komunitete dhe grupe formale dhe informale që kanë në mesin e tyre, ose njohin dhe janë të ekspozuar me punën dhe përkushtimin e personave të ndryshëm, përfshi këtu burra dhe gra, të rinj etj. dedikuar fuqizimit të grave dhe vajzave në zonat rurale dhe ndryshimeve pozitive në komunitet rural, të nominojnë individë për marrjen e këtij çmimi.

Për të nominuar kandidatët duhet të plotësohet një format aplikimi (Aneksi 1) dhe të dërgohet në adresat e e-mail info@anrd.al dhe info@adadmalore.al deri më datë 30 Shtatorit me titullin Aplikim për çmimin “Liljana Isakaj”.

Fituesi/ja e çmimit do të përzgjidhet nga një juri e përbërë nga tre përfaqësuesit e:

- Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- Shoqata e Zhvillimit të Bujqësisë të Rretheve Malore - ADAD Malore;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pas vendimit të jurisë, Sekretariati në ANRD do të kontaktojë propozuesit në mënyrë që të komunikojë këtë vendim te propozuesit dhe të nominuarit/ës dhe të bëjë organizimet e duhura për pjesëmarrjen e tyre dhe të një grupi përfaqësues të komunitetit të vajzave dhe grave me të cilat ka punuar fituesi/ja e çmimit.

Ndarja e çmimit do të organizohet më 15 tetor 2026, gjatë eventit të përvitshëm “Pro Grave Rurale”. Ky event përkon me Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale dhe shërben si një platformë për të bërë bashkë gratë dhe vajzat e komuniteteve rurale për t’u përfshirë në diskutime rreth shqetësimeve të tyre, prioritetëve dhe hapave që institucionet duhet të ndërmarrin. Kjo përpjekje e qëndrueshme advokacie njeh rolin dhe kontributet e rëndësishme të grave në bujqësi dhe zhvillimin rural, ndërsa nxit solidaritetin mbarëshoqëror për fuqizimin e grave dhe vajzave në zonat rurale. Eventu organizohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në bashkëpunim me organizatat anëtare të veta.

1. Formati i aplikimit

Çmimi “Liljana Isakaj”, Për Lidership në Fuqizimin e Grave të Zonave Rurale është një nismë kushtuar nderimit të trashëgimisë së pasur të Liljana Isakajt, e cila ia kushtoi jetën mbështetjes dhe fuqizimit ekonomik të prodhuesve të vegjël, veçanërisht grave dhe vajzave në zonat rurale. Si epitomë e grave rurale, Liljana hapi rrugën për progres, lidership dhe ndryshim pozitiv në komunitetet rurale. Ky çmim vlerëson individë që kanë kryer përpjekje për të përmirësuar jetën e grave dhe vajzave në zonat rurale dhe synon të krijojë një trashëgimi që nxit zhvillimin dhe progresin e vazhdueshëm të komuniteteve rurale shqiptare.

1. Emri dhe përshkrim i shkurtër i organizatës/institucionit/ biznesit/komunitetit/apo grupit që nominon:
2. Personi i kontaktit (emër/mbiemër)
3. E-mail i personit të kontaktit _____
4. Tel i personit të kontaktit _____
5. Emër Mbiemër i Personit që nominoni për çmimin: _____
6. Gjinia _____
7. Mosha _____ vjeç

Bëni një përshkrim të të nominuarit/ës ku të përfshini angazhimin e tij/saj në nisma për fuqizimin e grave dhe vajzave në bujqësi dhe zhvillimin rural dhe kontributin që ka dhënë në këtë drejtim:

Ju faleminderit për kontributin tuaj!